



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 20.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **18.07.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Arhiko.Ing SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i detyrës projektuese për SP të Ferizajt”** me Nr. të Prok: **206-23-3335-2-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Arhiko.Ing SH.P.K** e dt. 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Hartimi i detyrës projektuese për SP të Ferizajt”** me Nr. të Prok: **206-23-3335-2-2-1**, kundër Njoftimi mbi vendimin e AK-se dhe letrat standarde, të publikuar në platformën elektronike me datën 11.07.2023.
2. **Vërtetohet** Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 11.07.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Arhiko.Ing SH.P.K** me date 18.07.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i detyrës projektuese për SP të Ferizajt”** me Nr. të Prok: **206-23-3335-2-2-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas **Arhiko.Ing SH.P.K**:

- Neni 1 i LPP: Qëllimi
- Neni 7 i LPP: Barazia në trajtim jo diskriminimi
- Neni 52 i LPP Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 56 i LPP: Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

- Neni 59 i LPP: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP: Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 64 i LPP: Dëshmitë e kërkesave
- Neni 65 i LPP: Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 66 i LPP: Përshatshmëria Profesionale
- Neni 69 i LPP: Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik-10-Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Pretendimi ankimor

Nga vendimi i datës: 14.07.2023 kemi marrë njoftimin që ne jemi të pasukseshëm në këtë procedurë të tenderimit.

Pas qasjes në dokumente zyrtare me datën 17.07.2023 ne kemi hasur në këto pa rregullësi.

Project Plus SH.P.K.PROing&Partners SH.P.K.; si një grup i operatoreve Ekonomik i shpallur fitues ka këto parregullësi.

-Pas qasjes në dokumente zyrtare kemi kërkuar vertetimin tatimor, certifikatën nga gjykata mbi denimet penale për perfaqësuesin e OE, certifikatën nga gjykata për operatorin ekonomik.

Gjatë verifikimit të dokumenteve kemi hasur se dokumentacionin e certifikatës nga gjykata mbi denimet penale për perfaqësuesin e OE nuk mund të verifikohet përmes QR-Kodit.

Ku Certifikata mbi denimet penale për Afrim Gashi është e verifikueshme, ndërsa e

Kujtim Zena mbi denimet penale nuk është e verifikueshme.

AK është dashur të eliminojë operatorin ekonomik për këtë procedurë, pasi që dokumentacioni nuk mund të verifikohet.

-Në këtë procedurë të tenderit ne jemi eliminuar me pretendimin se nuk kemi dëshmi se kemi projektuar (ose)mbikqyrur se paku një objekt shendetësor të nivelit Qendror (ose)Mjekësisë familjare e me lartë.

Duke u bazuar në **UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve**, Atehere shkohet qartas që mund të kërkojë informata shtesë në rast se mungon referenca/Certifikata të pranimit nga lista e kontratave të prezantuara,

Andaj komisionin vlerësues është dashur që të kërkojë informata shtesë dhe jo eliminojë nga procedura, si dhe mos të shpall fitues një operator ekonomik të papërgjegjshëm pasi që ky operator nuk ka përmbushur kërkesën Pranueshmëria e Operatoreve Ekonomik 6.4. të dosjes së tenderit

Paragrafi 1 i nenit 7-të LPP-së e parasheh qartas që Autoriteti Kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, Poashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së një aktiviteti të prokurimit të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë që (vi) që tenderi i zgjedhur të pëpërdhet me të gjitha aspektet përmbajtëse të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse mirepo AK-ja nu ki është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, oasi që dihet edhe qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkojmë nga ana juaj si AK që kërkesa jonë të merret parasysh dhe lënda të kthehet në Ri Vlerësim pasi që e gjithë kërkesa jonë është e bazuar në fakte dhe argumente në të kundërtën nëse kompani do të vazhdojmë me procedurat e tjera konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin ankimor te OE ankues

Ne lidhje me dispozitën e shkelur për te cilët pretendon Arhiko.Ing SH.P.K, Autoriteti Kontraktues e hedhë poshtë komplet pretendimin e OE ankues, si te pa bazuar dhe pa asnjë te drejte.

Pretendimi ankimor i OE ankues ka te beje ekskluzivisht me Vërtetimin nga gjykata mbi dënimet penale për përfaqësuesin e OE te rekomanduar, konkretisht për Z. Kujtim Zena nga anëtari i konsorciumit Partners SH.P.K., qe sipas OE ankues nuk mund të verifikohet përmes QR-Kodit.

Për ta vërtetuar dokumentin e atakuar me këtë pretendim, ne si AK-MSH kemi kërkuar me shkrim konfirmim nga Gjykata Themelore Gjakovë dega në Rahovec dhe nga zyrtari përgjegjës Z. Sylka kemi marre konfirmimin me shkrim si ne vijim:

Përsëendetje i nderuar, po Ju informoj në lidhje me Email-in e Juaj, njëherit Ju njoftojm se Çertifikata e lëshuar nga Gjykata Themelore Gjakovë dega në Rahovec është lëshuar në mënyrë të rregullt dhe e njëjta është origjinale, këtë përgjigje po Ju konfirmojmë nga se e kemi vërtetuar në prograimin e Evidencës Penale.

Ndodhin rastet kur nuk mund të verifikohet përmes QR – Kodit, por e njëjta është vërtetuar dhe është konstatuar se është origjinale.

OE i rekomanduar është oferta me çmimin me te lirë dhe pretendimi i OE ankues për shkelje te nenit 1 te LPP-se është totalisht i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit pse nuk kemi kërkuar sqarime shtese, për arsyen e eliminimit qe nuk projektuar (ose) mbikëqyrur se paku një objekt shëndetësor te nivelit Qendror (ose) Mjekësisë familjare e me larte.

Ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse ne Njoftim për kontrate dhe ne Dose te Tenderit, qartazi është specifikuar kriteri Nr. 1 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, si ne vijim:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata ne projektim ose mbikëqyrje ose shërbime tjera profesionale inxhinjrike, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 35,000 Euro, dhe te ofroj dëshmi se ka projektuar (ose) mbikëqyrur se paku një objekt shëndetësor te nivelit Qendror (ose) Mjekësisë Familjare e me larte.


OE ankues ka prezantuar ne oferte Listen me 27 Projekte, ku asnjeri prej tyre nuk permban te dhena qe ka projektuar (ose) mbikëqyrur se paku një objekt shëndetësor te nivelit Qendror (ose) Mjekësisë familjare e me larte, siç është kërkuar ne këtë tender.

Ju si OE ankues eshte dasht ta lexoni me mire kriterin e Dosjes se tenderit dhe te dini me çfare dokumentacioni duhet ta plotesoni kriterin, e jo te beni ankesa te tilla pa bazë dhe te na prolongoni aktivitetin dhe si rrjedhoje tere projektin e Spitalit te Ferizajt, si nje nga prioritetet investive te MSH-se.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit